



Rreth DIYPES



DIYPES (Bëje vetë! Një qasje e re për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve të shkollave të mesme në orët e edukimit fizik) ka testuar një qasje të re për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve të shkollave të mesme në orët e edukimit fizik.

Qëllimi kryesor i projektit është të ndryshojë sjelljet dhe qëndrimet e nxënësve ndaj edukimit fizik, gjë që do të ndikonte drejtpërdrejt në shëndetin e tyre si nga ana psikologjike ashtu edhe nga ajo fizike. DIYPES ka përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt studentë, mësues të edukimit fizik, hulumtues dhe specialistë të edukimit fizik, të cilët punojnë në një ekip për krijimin e qasjeve të reja dhe kthimin e orëve të edukimit fizik në momente argëtimi dhe jo në orë të humbura në orarin ditor të shkollës. Projekti po zbatohet në kuadër të programit Erasmus + Sport, i cili ka filluar në janar 2017 dhe do të zgjasë dy vjet.

Në 5 vendet evropiane të përfshira në projekt (Shqipëria, Italia, Malta, Rumania dhe Sllovakia), aktivitetet e DIYPES do të kontribuojnë për të identifikuar, testuar, përshkruar dhe sugjeruar praktikat më të mira në strukturimin e orëve të edukimit fizik në mënyrë të tillë që të sigurojnë rritjen e angazhimit dhe gadishmërinë e studentëve për të marrë pjesë në këto orë mësimi.

Për më tepër, projekti teston fizibilitetin dhe efektivitetin e një ndërhyrjeje tre mujore përmes një qasjeje pjesëmarrëse në orët e edukimit fizik. Shumëllojshmëria e shkollave pjesëmarrëse në projekt jep mundësinë e krahasimit të rezultateve midis vendeve, për të vënë në dijeni teknika të ndryshme, për të zbuluar korrelacione të reja dhe rrugëzgjidhje në trajtimin e çështjeve aktuale lidhur me edukimin fizik.

Progresi Aktual

Takimi i 2-të në Mallë i punës në kuadër të projektit u zhvillua në Kompleksin Sportiv Kirkop, me pjesëmarrjen e hartuesve të politikave, hulumtuesve, mësuesve të edukimit fizik dhe nxënësve, të cilët ishin të përfshirë në zbatimin e projektit. Takimi përfshiu seanca pune ku u shqyrtuan rezultatet e dala nga zbatimi i ndërhyrjes në të gjitha shkollat ku hartuesit e politikave, mësuesit e edukimit fizik dhe nxënësit, nga vendet partnere, diskutuan për të evidentuar modelet e suksesit të zbatueshme në të gjitha shkollat në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies në orët e edukimit fizik.



Rezultatet deri tani

- Është analizuar kurrikula e lëndës së Edukimit Fizik në 5 vendet partnere duke përdorur analizën tematike të dokumenteve zyrtar kurrikular dhe intervistat me specialistë dhe mësues të edukimit fizik.
- Projekti DIYPES u prezantua në zyrat rajonale arsimore dhe shkollat e mesme të përfshira në 5 vendet partnere.
- Ndërhyrja 3 mujore është zbatuar në një popullsi me rreth 1250 nxënës nga 15 shkolla të mesme në vendet partnere.

Takimet e konsorciumit në kuadër të projektit DIYPES



Takimi i parë i projektit u zhvillua në Cluj-Napoca, Rumani, më 27-28 shkurt 2017, organizuar nga Koordinatori i projektit DIYPES, Universiteti Babes-Bolyai, Departamenti i Shëndetit Publik.



Takimi i 1-rë i punës u zhvillua në Romë, Itali më 11-12 dhjetor 2017, organizuar nga Këshilli Kombëtar i Kërkimeve në Itali dhe koordinatori i projektit, Universiteti Babes-Bolyai, Rumani.



Takimi i 2-të i punës u zhvillua në Maltë, më 19-21 qershor 2018, organizuar nga Fondacioni për Promovimin e Përfshirjes Sociale në Maltë dhe koordinatori i projektit, Universiteti Babes-Bolyai, Rumani.



Takimi i fundit i projektit organizuar nga një vend partner u zhvillua në Tiranë, Shqipëri, më 5 - 7 dhjetor 2018, organizuar nga Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe koordinatori i projektit, Universiteti Babes-Bolyai, Rumani.

Cilët do të jenë hapat në vazhdim?

Rezultatet e secilës ndërhyrje dhe reagimet nga të gjithë pjesëmarrësit dhe palët e tjera të përfshira në projekt do të hartohen në një udhëzues të përbashkët për praktikën më të mirë, i cili mund të përdoret në nivel evropian dhe të inkurajojë përdorimin e qasjeve të reja pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e orëve të edukimit fizik.

Në çdo vend pjesëmarrës do të organizohet një takim për prezantimin e arritjeve adresuar mësuesve të edukimit fizik dhe praktikuesve të tjerë, për të inkurajuar dhe mbështetur këto kategori profesionistësh në përdorimin e ndërhyrjes së zhvilluar në praktikën e përditshme të mësimdhënies.



info@diypes.eu

www.diypes.eu